



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:246604

Datë: 13.02.2024

Numri i dokumentit: 05321317

C.nr.67/2015

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike civile të paditëses D. I. G., nga Prishtina, përfaqësuar me autorizim nga F. U. I., avokate në Prishtinë, kundër të paditurit A. S., nga Lipjani, përfaqësuar me autorizim nga N. G., avokat në Lipjan, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, pas përfundimit të seancës përgatitore, më datë 13.02.2024, dha këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË POHIMIT

I. VËRTETOHET se paditësja D. I. G., nga Prishtina, është pronare e tërë pjesë ideale në patundshmërinë e përshkruar në ngastrën kadastrale numër ..., ne sipërfaqe prej 371 m², lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: Private, zona: Rurale, lloji i shfrytëzimit të parcelës: Bujqësore, shfrytëzimi aktual i parcelës: Arat, kualiteti i klasës: Arë e klasës 4, e cila gjendet në vendin e quajtur "...", Zona Kadastrale Çagllavicë, e cila evidentohet në emër të paditurit A. (I.) S.

II. DETYROHET i padituri që paditëses, t'ia pranoj të drejtën e pronësisë, si dhe të lejoj që e njëjta patundshmëri e përshkruar si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, të bartet dhe të regjistrohet ne emër te paditësit, pran ZKK në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

III. Secila pale i bart shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarës së saj, ka parashtruar padi kundër të paditurit, për shkak të vërtetimit të pronësisë me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësja D. I. G., nga Prishtina, është pronare e tërë pjesë ideale në patundshmërinë e përshkruar në ngastrën kadastrale numër ..., ne sipërfaqe prej 371 m², lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: private, zona: rurale, lloji i shfrytëzimit të parcelës: bujqësore, shfrytëzimi aktual i parcelës: Arat, kualiteti i klasës: Arë e klasës 4, e cila gjendet në vendin e quajtur "...", Zona Kadastrale Çagllavicë, e cila evidentohet në emër të paditurit A. (I.) S., dhe të detyrohet i padituri që paditëses, t'ia pranoj të drejtën e pronësisë, si dhe të lejoj qe e njëjta patundshmëri e përshkruar si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, të bartet dhe të regjistrohet ne emër te paditësit, pran ZKK në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

I padituri, përmes të autorizuarit të tij në seancën e datës 13.02.2024, ka deklaruar se meqenëse paditësja ka përmbushur detyrimet ndaj të paditurit, nuk ka kundërshtuar kërkesën e saj duke e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit, duke i propozuar gjykatës që të bie aktgjykim në bazë të pohimit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Meqenëse i padituri, paditësit ia pranoj të drejtën e pronësisë, gjykata pa shqyrtim të mëtejme jep aktgjykim në bazë të pohimit me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit, pasi që konsideron se kemi të bëjmë me kërkesa më të cilat palët mund të disponojnë lirshëm, e nuk janë në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 3 par. 3 i LPK-së , duke u bazuar në nenin 148 par. 1, e lidhur me nenin 398 te LPK-së, vendosi sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Gjykata konsideron se themelësia e kërkesëpadisë është vërtetuar me faktet e treguara me padi, dhe e faktet mbi te cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë ne kundërshtim me provat qe i ka propozuar paditësi siç janë certifikata e pronësisë për ngastrën kadastrale ..., ZK Çagllavicë.

Gjykata në kuptim të nenit 148.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore pas pohimit të kërkesëpadisë nga i autorizuari i të paditurit në seancën përgatitore kryesor nuk ka marrë

menjëherë aktgjykim në bazë të pohimit, derisa është siguruara së në rastin konkret është fjala për kërkesa me të cilat palët mundë të disponojnë lirisht. Pasi që gjykata është bindur së bëhet fjalë për kërkesa të disponueshme të palëve në kuptim të nenit 148.1 të LPK-së, pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse, ne rastin konkret kemi të bëjmë me pohimin e kërkesëpadsisë dhe është nxjerr aktgjykim ne bazë të pohimit, atëherë gjykata arsyetoi vetëm arsyet të cilat e justifikojnë dhënien e këtij aktgjykimi konform nenit 160 paragrafi 6 të LPK-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata ka vendosur si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit, duke u bazuar në nenin 463 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore meqenëse asnjëra palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Rrjedhimisht nga sa u tha si në pjesën arsyetuese u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.67/2015, më 13.02.2024.

Përparim Zeka

Gjyqtar

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Bazuar në nenin 181.2 të LPK-së, ky aktgjykim mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin eventual të dhunës apo mashtrimit.